

D E K R E T
Nr.1500, datë 26.5.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7556, DATË 4.2.1992 "PËR ZGJEDHJET E
KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR.8055, DATË 1.2.1996**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në nenin 64, paragrafi i dytë, të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992, i ndryshuar me ligjin nr.8055, datë 1.2.1996 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë" bëhet ky ndryshim:

"Votimi fillon në orën 7⁰⁰ dhe mbyllet në orën 22⁰⁰. Në qoftë se pas orës 22⁰⁰ ka ende njerëz që presin të votojnë, votimi vazhdon derisa të mbarojnë të gjithë të pranishmit".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha